



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura V**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 1.6.2016, ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama dhe Jelena Bontiq.

Munguan: Shqipe Pantina, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesit e KPMSHCK-së, OSBE-së, GAP-it, NDI-së, KDI-së, BIRN-it, ZPRK-së, Radio Kosova, Tribuna, Arbreshinfo dhe Radio Dukagjini.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2015;**
- 3. Votimi i Raportit vjetor të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2015;**
- 4. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2015;**

**Zenun Pajaziti**, tha se Komisioni ka shqyrtuar raportin nga i cili shihet përkushtimi i Këshillit për punën njëvjeçare dhe ia kaloi fjalën anëtarëve të Këshillit për prezantimin e Raportit vjetor.

**Lulzim Aliaj**, Kryetari i KPMSHCK-së, tha se si institucion kushtetues dhe ligjor, përball vështirësive me hapësirë pune dhe buxhet, kemi arritur të bëjmë monitorimin e Ligjit dhe të kthejmë besimin tek nëpunësit civilë.

Sa i përket procesit të monitorimit, vëzhgimit dhe shqyrtimit të ankesave, kemi pasur mbi 600 ankesa, të cilat janë nga kontestet e konkurseve dhe kompensimet materiale. Sfidë tek zgjedhja e ankesave është kolizioni i ligjeve lidhur me emërimin e nëpunësve si shërbyes civilë.

**Zenun Pajaziti**, lidhur me kolizionin e ligjeve, tha se Komisioni do të organizojë një takim me disa institucione, të cilat kanë në fushëveprim plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve.

**Alma Lama**, pyeti lidhur me vendimet e Këshillit, kush i dërgon vendimet në gjykatë?

**Xhevahire Izmaku**, tha se janë të përsëritura shkeljet ligjore nga disa institucione. Është shqetësuese që ankesat janë për institucionet e nivelit qendror, në këtë kontekst, ajo pyeti, ankesat e nëpunësve të gjinisë femërore, a duhet të konsiderohen si ankesa për arsye të pabarazisë gjinore.

**Kujtim Paçaku**, pyeti se a është përmbushur, konform Ligjit, norma prej 10 për qind për punësimin e minoriteteve dhe a ka shkelje në këtë drejtim?

**Sadri Ferati**, lidhur me shkeljet ligjore pyeti, a janë të gjitha publike?

**Lulzim Aliaj**, u përgjigj në pyetjet e anëtarëve të Komisionit, duke thënë se është me rëndësi që të gjitha vendimet e Këshillit merren në mënyrë unanime.

Vendimet e Këshillit dorëzohen në gjykatë nga vet palët, për arsye se Këshilli nuk ka mandat me i dërgua vendimet në gjykatë sepse këtë nuk ia lejon Ligji.

Këshilli nuk ka përfunduar me zgjidhjen e disa ankesave të shërbyesve civilë, për arsye se disa institucione kanë nxjerr akte nënligjore, që nuk janë në pajtim me Ligjin, dhe sipas së cilave akte nënligjore disa shërbyes përjashtohen nga Ligji për Shërbimin Civil si fjala vjen në ATK, Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Sa i përket çështjes së punësimit të minoriteteve në nivelin qendror nuk ka shkelje, ndërsa në nivelin lokal nuk do të thotë punësimi i minoriteteve në komuna të jetë prej 10%, sepse kjo shifër është e ndryshueshme varësisht prej përqindjes së përfaqësimit të minoriteteve në komuna.

**Konstatim:** Komisioni njëzëri, miratoi raportin vjetor dhe nxori rekomandimin si në vijim:

---

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 67 dhe 72, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 1.06.2016, shqyrtoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2015, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

### **R e k o m a n d i m**

1. Të miratohet Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2015;
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

## **Arsyetimi**

Në bazë të nenit 19 të Ligjit nr. 03/L-192, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ia paraqet Raportin vjetor të punës Kuvendit të Kosovës.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 1.06.2016, shqyrtoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2015 dhe vlerësoi se Raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 19 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

### **3. Votimi i Raportit vjetor të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2015;**

Kryetari i komisionit kërkoi nga anëtarët që të votohet për Raportin e RTK-së, meqë ky raport është shqyrtuar në mbledhjen e kaluar të Komisionit.

Komisioni me 3 vota “për” dhe 2 vota “kundër”, miratoi Raportin e RTK-së dhe nxori rekomandimin si në vijim:

---

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 67 dhe 72, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 1.06.2016, shqyrtoi Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2015, dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqet këtë,

## **R e k o m a n d i m**

1. Të miratohet Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2015;
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

## **Arsyetimi**

Në bazë të nenit 21, paragrafi 6, pika 1 dhe të nenit 38.4, të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Radiotelevizioni i Kosovës ia dorëzon Kuvendit raportin vjetor të aktiviteteve jo më vonë se deri më 31 mars, si dhe raportin vjetor për debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së për qëllime orientuese.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 1.06.2016, shqyrtoi Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, dhe vlerësoi se i njëjti përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Mbledhja përfundoi në orën: 14:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

-----  
Zenun Pajaziti